



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.14, datë 28.12.2020

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS:
“NDËRTIMI I RRUGËS PORTI I JAHEVE-BYPASS ORIKUM-DUKAT
(URA E SHËN ELIZËS)”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË VLORË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë koncesionare “Ruga Orikum-Llogara” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës: “Ndërtimi i rrugës Porti i Jaheve-Bypass Orikum-Dukat (Ura e Shën Elizës)”, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me zhvillues shoqërinë koncesionare “Ruga Orikum-Llogara” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vlorë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR LLINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELINDA BALLUKU

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

